



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 756/20; Datë: 02.03.2020

Në bazë të nenit 23 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 02.03.2020, merr

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja mbi Zgjedhjet në UShAF dhe Punën e Këshillit Mësimor/ Shkencor.
- II. Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në UShAF, pas elaborimit të draft rregullore në fjalë, në mënyrë unanime vendosi në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet DALIPI



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 756/20, Dt.: 02.03.2020

**RREGULLORE MBI ZGJEDHJET NË UNIVERSITETIN
E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ
DHE PUNËN E KËSHILLIT MËSIMOR/SHKENCOR**

Ferizaj, Mars, 2020

S.D.

Në mbështetje të nenit 23, pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm (në tekstin e mëtejshëm Statuti) të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), si dhe në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e zgjedhjeve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 02.03.2020, miraton:

RREGULLOREN
MBI ZGJEDHJET NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ
DHE PUNËN E KËSHILLIT MËSIMOR/SHKENCOR

Neni 1

Me këtë Rregullore, do të rregullohet procedura e zgjedhjeve në Këshillin Mësimor/Shkencor në UShAF, si dhe mënyra e punës së tij.

I. Procedura a e zgjedhjeve në Këshillin Mësimor/Shkencor

Neni 2

Përbërja e Këshillit Mësimor/Shkencor të UShAF duhet të jetë konform nenit 50 të Statutit të UShAF dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

1. Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Mësimor/Shkencor, bëhen në bazë të listës prioritare të votave të fituara në programet e studimit në UShAF.
2. Për anëtar të Këshillit Mësimor/Shkencor, përveq anëtarëve të cekur në pikën 1 të këtij neni, me proces të rregullt të votimit zgjedhen drejtorët e programeve të studimit, të cilët ratifikohen në Senat dhe përfaqësuesit e përkohshëm të drejtorëve të programeve të studimit në Këshillin Mësimor/Shkencor, të cilët kanë mandat deri në ratifikimin e drejtorëve të programeve në Senat.
3. Të drejtë për t'u zgjedhur për pikat 1 dhe 2 të këtij neni kanë i gjithë stafi nga radhët e profesorëve, ligjëruesëve, asistentëve dhe lektorëve nga programi respektiv dhe të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune.
4. Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Mësimor/Shkencor nga radhët e administratës, të drejtë vote ka i tërë personeli jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UShAF.
5. Një përfaqësues nga radhët e studentëve në Këshillin Mësimor/Shkencor zgjedhet sipas propozimit të Parlamentit Studentor të UShAF, konform dispozitave të Rregullores mbi zgjedhjet e studentëve.
6. Nuk kanë të drejtë të zgjedhen apo të zgjedhin të gjithë kandidatët të cilët bien ndesh me nenin 17, pika 3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për shkak se një gjë e tillë konsiderohet si konflikt interesi.

S.O.

II. Verifikimi i mandateve

Neni 4

1. Këshilli Mësimor/Shkencor në mbledhjen e parë bënë verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Mësimor/Shkencor në bazë të raportit të përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm i UShAF-it, për rregullsinë e zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit Mësimor/Shkencor, me propozim dhe verifikimin e mandatit.
2. Votimi për raportin bëhet në tërësi, nëse nuk është kontestuar asnjë mandat. Në rast se ndonjë mandat kontestohet, së pari votohet për të gjitha mandatet e pakontestueshme, e pastaj votohet për çdo mandat të kontestueshëm veç e veç.
3. Nëse Këshilli Mësimor/Shkencor konstaton se zgjedhja është bërë në mënyrë jo të rregullt, kërkohet që zgjedhja e kontestuar të përsëritet.
4. Anëtarit të Këshillit Mësimor/Shkencor të UShAF-it që i është kontestuar ose i është shtyrë vendimi për verifikimin e mandatit, ka të drejtë të vazhdojë pjesëmarrjen në mbledhje, por pa të drejtë vote.
5. Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor e nënshkruajnë Deklaratën Etike, si vijon: "Deklaroj se do t'i kryej detyrat me nderë dhe me besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t'i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e UShAF-it dhe se do t'i përmbahem Statutit të UShAF".

III. Zgjedhja e përfaqësuesit të përkohshëm të dekanit

Neni 5

1. Dekanët e fakulteteve zgjedhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Mësimor/Shkencor dhe i propozohen Senatit për miratim.
2. Deri në zgjedhjen, respektivisht ratifikimin e dekanëve nga Senati, Këshilli Mësimor/Shkencor zgjedhë përfaqësuesit e përkohshëm të dekanëve, mandati i të cilëve përfundon me ratifikimin e dekanëve nga Senati.
3. Çdo anëtar i Këshillit Mësimor/Shkencor ka të drejtë të bëjë propozime për kandidatë për pozitën e përfaqësuesit të përkohshëm të dekanit. Nominimi i kandidatëve për dekan bëhet me shumicë të thjeshtë, me votim të hapur për secilin kandidat veç e veç.
4. Për kandidatët e nominuar organizohet votim i fshehtë.
5. Nëse asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë radha e dytë e votimit bëhet vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli Mësimor/Shkencor është i obliguar që të propozoj kandidat tjetër.
6. Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet.

S. A.

IV. Zgjedhja e përfaqësuesëve të Senatit

Neni 6

1. Përfaqësuesit e fakulteteve në Senat, për çdo njësi akademike zgjedhen nga radhët e personelit akademik (profesor, ligjërues, asistent dhe lektor) në marrëdhënie të rregullt pune në UShAF me proces të rregullt të votimit.
2. Anëtari i Senatit nga stafi jo-akademik, zgjedhet nga radhët e personelit jo-akademik në marrëdhënie të rregullt pune me proces të votimit nga administrata e UShAF.

V. Kandidimi

Neni 7

Të gjithë të interesuarit për t'u zgjedhur si drejtor i programit, përfaqësues i përkohshëm i drejtorit të programit në Këshill Mësimor/Shkencor, antarë të rregullt të Këshillit Mësimor/Shkencor dhe në Senat, paraprakisht duhet të paraqiten për kandidaturë, sipas dinamikës së zgjedhjeve në UShAF.

VI. Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të Këshillit Mësimor/Shkencor

Neni 8

Kryesuesi i përkohshëm i Këshillit Mësimor/Shkencor, zgjedhet kandidati më i vjetër i Këshillit Mësimor/Shkencor të UShAF-it, i cili do të udhëheqë mbledhjet deri në zgjedhjen e Prorektorit për Mësim, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore, i cili është ex officio kryesues i Këshillit Mësimor/Shkencor.

VII. Mbledhjet

Neni 9

1. Kryesuesi i Këshillit Mësimor/Shkencor thërret dhe kryeson mbledhjen.
2. Në rast se kryesuesi mungon, mbledhjen e përgatitë dhe e kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit Mësimor/Shkencor.
3. Kryesuesi, mbledhjet i thërret sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Këshillit Mësimor/Shkencor mbahen së paku një herë në muaj.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe, sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këtë mbledhje duhet të jetë i kufizuar në një pikë kryesore të rendit të ditës. Në mbledhjen e Këshillit Mësimor/Shkencor, mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhje të ardhme të Këshillit Mësimor/Shkencor dhe në këtë rast anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor që nuk janë të pranishëm duhet të ftohen posaçërisht.

S. D.

5. Në rast të shkarkimit të kryesuesit të Këshillit Mësimor/Shkencor, procedurën e zgjedhjes e organizon anëtari më i vjetër i Këshillit Mësimor/Shkencor, pa asnjë vonesë.
6. Mbledhjet e Këshillit Mësimor/Shkencor janë të hapura për publikun, pos në rastet kur Këshilli Mësimor/Shkencor vendos ndryshe.
7. Anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor ftohen së paku tri ditë para mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me fax, e-mail, ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurta.
8. Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe të ftojë ekspertë, ose të ftojë persona të tjerë në mbledhje.
9. Kryesuesi është i obliguar të thërras mbledhjen e Këshillit Mësimor/Shkencor, nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Këshillit Mësimor/Shkencor dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim. Nëse kryesuesi i Këshillit Mësimor/Shkencor nuk i përgjigjet kërkesës brenda tri ditësh nga dita e marrjes së kërkesës, mbledhjen e Këshillit Mësimor/Shkencor e thërret anëtari më i vjetër i Këshillit Mësimor/Shkencor.

VIII. Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi

Neni 10

1. Të gjithë anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor, kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Mësimor/Shkencor.
2. Gjatë mbledhjeve të Këshillit Mësimor/Shkencor, anëtarët duhet të votojnë personalisht, delegimi i votës nuk lejohet.
3. Para se të filloj mbledhja e Këshillit Mësimor/Shkencor, anëtarët duhet të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Këshillit Mësimor/Shkencor, mund të mungoj nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i Këshillit Mësimor/Shkencor duhet të njoftojë me kohë kryesuesin.
4. Mbledhja e Këshillit Mësimor/Shkencor, mund të mbahet nëse ka kuorum prej 50+1% të anëtarëve.

Neni 11

Një anëtar i Këshillit Mësimor/Shkencor konsiderohet se ka konflikt interesi, në pajtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe Statutin e UShAF, nëse bie ndesh me interesin e tij publik, familjar dhe operacional.

1. Nëse Këshilli Mësimor/Shkencor nuk vendos ndryshe, anëtari në konflikt interesi duhet të lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur ajo çështje diskutohet.
2. Anëtari në konflikt interesi nuk ka të drejtë vote për çështjen përkatëse.

S.O.

IX. Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

Neni 12

1. Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen.
2. Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Këshillit Mësimor/Shkencor, kujdeset kryesuesi në koordinim me Sekretarin e Përgjithshëm të UShAF dhe shërbimet administrative të UShAF.
3. Kryesuesi është i obliguar që në rend të ditës të përfshijë propozimet e arsyetuara me shkrim, 72 orë para mbajtjes së mbledhjes. Propozimet me shkrim mund të dërgohen personalisht, ose me e-mail dhe të jenë të nënshkruara nga parashtruesi.
4. Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin e rendit të ditës.
5. Kryesuesi ia jep fjalën diskutuesit, konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes konform me këtë Rregullore.
6. Anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin.
7. Materialet ose kërkesat, të cilat bashkangjiten gjatë mbledhjes, ato mund të miratohen me shumicën absolute të votave.

X. Ecuria e mbledhjes

Neni 13

1. Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
2. Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës, e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, e pastaj kryesuesi e hap diskutimin.
3. Të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit Mësimor/Shkencor, mund të marrin pjesë në diskutim, si dhe t'i paraqesin mendimet dhe propozimet lidhur me çështjet që do të vendosen në mbledhje.
4. Kryesuesi jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjen e Këshillit Mësimor/Shkencor, askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
5. Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e procedurave të punës për veprimet dhe sjelljen e anëtarëve sipas radhës.

S. O.

6. Për çdo pikë të rendit të ditës, pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti dy herë. Herën e parë pesë minuta, ndërsa herën e dytë dy minuta.
7. Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësi që t'i përmbahet temës së pikës në rend të ditës.
8. Pjesëmarrësi i cili merr fjalën është i obliguar t'i përmbahet çështjes që është në shqyrtim. Çdo pjesëmarrës që konsideron se lidhur me fjalën e tij është shtrembëruar ndonjë fakt, me lejen e kryesuesit ka të drejtë të paraqitet për replikë, menjëherë pasi të përfundoj diskutimin pjesëmarrësi ndaj të cilit është paraqitur replika. Replika për të njëjtën çështje i lejohej pjesëmarrësit në diskutim vetëm dy herë dhe sipas rregullit mund të zgjasë më së shumti dy minuta.
9. Kryesuesi ka të drejtë të ndërpresë mbledhjen më së shumti 30 minuta. Me pajtimin e Këshillit Mësimor/Shkencor, koha e ndërprerjes mund të zgjatet.
10. Kryesuesi është i obliguar të ndërpresë mbledhjen, nëse ai vetë nuk ka mundësi ta udhëheqë në mënyrë të drejtë.

Neni 14

Këshilli Mësimor/Shkencor, në bazë të propozimit të kryesuesit ose të ndonjë anëtari të Këshillit Mësimor/Shkencor, mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e arshme.

XI. Kërkesat dhe ankesat

Neni 15

1. Çdo anëtar i Këshillit Mësimor/Shkencor ka të drejtë të parashtrojë kërkesë - ankesë për temën e caktuar.
2. Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa-ankesa të parashtrohet me shkrim.
3. Kërkesat - ankesat për rregullat procedurale duhet të arsyetohen shkurtimisht. Me kërkesë, një folës për dhe një folës kundër mund të marrin fjalën. Kërkesat - ankesat për rregullat e procedurës mund të parashtrohen për dy arsye:
4. Kërkesa për mbylljen e listës së folësve të regjistruar, nëse kërkesa miratohet me shumicë të thjeshtë, vetëm folësit e regjistruar në listë gjatë parashtresës së kërkesës.
5. Kërkesa për përfundimin e shqyrtimit, nëse kërkesa miratohet me shumicë të kualifikuar të 2/3 të anëtarëve, diskutimi mbaron dhe kërkesat tjera votohen.

S. D.

XII. Vendimarrja - votimi dhe zgjedhja

Neni 16

1. Vendimet e Këshillit Mësimor/Shkencor janë të plotëfuqishme nëse për të votojnë shumica e thjeshtë e anëtarëve prezent.
2. Para votimit, kryesuesi formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
3. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës së Këshillit Mësimor/Shkencor, merret vendim ose konkluzion.
4. Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose propozimet nga autoritetet në UShAF, pastaj për propozimet tjera.
5. Votimi bëhet me aklamacion, duke ngritur dorën apo me votën e fshehtë. Kjo çështje vendoset në takimin e Këshillit Mësimor/Shkencor.
6. Votimi bëhet PËR, KUNDËR dhe Abstenim.
7. Në rast të numrit të votave të barabarta, propozimi konsiderohet i refuzuar.

Neni 17

1. Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga Këshilli Mësimor/Shkencor, i përbërë prej tre anëtarëve.
2. Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi, përkatësisht kryetari i komisionit, konstaton se propozimi i vendimit ose konkluzionit është miratuar ose është refuzuar.

Neni 18

Votimi me vota të fshehta bëhet për:

1. Zgjedhjen e dekanit, i cili dërgohet për miratim në Senat;
2. Zgjedhjen e kryesuesit të përkohshëm të Këshillit Mësimor/Shkencor;
3. Zgjedhja e përfaqësuesëve të përkohshëm të dekanëve në Senat;
4. Çështjet që prekin integritetin personal të ndonjërit nga anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor;
5. Çështjet kur kryesuesi kërkon votim të fshehtë;

Numrimi i votave për këto çështje bëhet nën mbikqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të UShAF.

S.O.

XIII. Zgjedhja e Dekanit – propozim për miratim në Senat

Neni 19

1. Dekanët e fakulteteve, zgjedhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Mësimor/Shkencor dhe i propozohen Senatit për miratim.
2. Çdo anëtar i Këshillit Mësimor/Shkencor, ka të drejtë të bëjë propozime për kandidatë për pozitën e dekanit. Propozimet për kandidat duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe një biografi të shkurtë për kandidatin. Nominimi i kandidatëve për dekan bëhet me shumicë të thjeshtë, me votim të hapur për secilin kandidat veç e veç.
3. Për kandidatët e nominuar organizohet votim i fshehtë.
4. Nëse asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë radha e dytë e votimit bëhet vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli Mësimor/Shkencor është i obliguar që të propozoj kandidat tjetër.
5. Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet.

XIV. Mbajtja e rendit në mbledhje

Neni 20

1. Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi i mbledhjes.
2. Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhje të Këshillit Mësimor/Shkencor janë të obliguar që t'iu pëmbahen rregullave dhe procedurave të mbledhjes.
3. Për shkeljen e rendit të mbledhjes mund të shqiptohen këto masa:
 - Vërejtje;
 - Marrja e fjalës;
 - Largimi nga mbledhja.

Neni 21

1. Vërejtja me gojë mund t'i shqiptohet të pranishmit nëse me sjelljen dhe diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
2. Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit, nëse me sjelljet dhe me deklaratën e tij çrregullon punën normale të Këshillit Mësimor/Shkencor, për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtja.
3. Vërejtjen dhe marrjen e fjalës e shqipton kryesuesi.
4. Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit, nëse edhe pasi t'i merret fjala pengon mbarëvajtjen e mbledhjes.

S. D.

5. Largimin nga mbledhja e shqipton Këshilli Mësimor/Shkencor me shumicë votash. Pjesëmarrësit të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për mbledhjen aktuale.

XV. Procesverbali nga mbledhja

Neni 22

1. Në çdo mbledhje të Këshillit Mësimor/Shkencor mbahet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.
2. Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - Vendin, datën, kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes;
 - Rendin e ditës;
 - Listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë;
 - Të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve;
 - Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.

Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit.

3. Ekstrakti i përgatitur nga procesverbali, u dërgohet anëtarëve të Këshillit Mësimor/Shkencor një javë pas mbajtjes së mbledhjes.
4. Ekstrakti miratohet në mbledhjen e radhës.
5. Procesverbali dhe ekstrakti ruhen në arkiv të UShAF, me materiale të shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës si dokumente afatgjata.

XVI. Aktet e Këshillit Mësimor/Shkencor

Neni 23

1. Këshilli Mësimor/Shkencor nxjerr:
 - Vendime;
 - Konkluzione;
 - Rekomandime.
2. Këshilli Mësimor/Shkencor jep interpretim autentik për dokumente që i lëshon.

Neni 24

Dispozitat e këtyre rregullave dhe procedurave vlejnë për të gjithë anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor dhe për personat tjerë të ftuar apo të angazhuar në Këshillin Mësimor/Shkencor.

S. D.

Neni 25

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit dhe akteve të tjera ligjore.

XVII. Dispozitat përfundimtare

Neni 26

1. Për zbatimin e drejtë të këtyre procedurave, kujdeset kryesuesi i Këshillit Mësimor/Shkencor.
2. Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e bënë Këshilli Drejtues.
3. Rregullorja hynë në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues.


Neni 27

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas së njejtës procedurë të miratimit.

Neni 28

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi zgjedhjet në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe punën e Këshillit Mësimor/Shkencor, nr. prot.: 2602/19 e dt. 26.07.2019.

Prof. As. Dr. Samet Dalipi


Kryesues i Këshillit Drejtues

